



PRANUAR ME: 27/04/2025
ACCEPTED ON:
PRIMLJENO: 01/492



Republika e Kosovës

Komuna e Malishevës

Plani i punës 2025

Ekrem Kastrati- Kryetar i Komunës së Malishevës

Të dashur bashkëqytetar të Komunës së Malishevës,

Viti 2025, është një vit pune me plot sfida, pasi është viti përfundimit të mandatit të parë si kryetar i komunës dhe rrjedhimisht edhe përfundimin e premtimeve tona si qeveri komunale, në veçanti për zbatimin e pjesës së parë të projektit madhor të “Malishevës Urbane”, projekt i cili deri më tani është realizuar me sukses dhe sipas planifikimeve.

Unë si kryetra i komunës, bashkë me qeverinë komunale, jam i përkushtuar në realizimin e të gjitha premtimeve, përmes së cilave synojnë rritjen e mirëqenies së qytetarëve tanë përmes projekteve konkrete, si në infrastrukturë të përgjithshme, me fokus qytetin, por duke mos lënë anash as fshatrat dhe vendbanimet tjera, pastaj subvencionimin në fushat që ndikojnë në zhvillimin e ekonomik.

Përkrahja në bujqësi, rritja e shërbimeve shëndetësore, menaxhimi i mbeturinave dhe shërbimet tjera komunale, përmirësimi i furnizimit me ujë për pije, rritja e cilësisë në arsim, janë vetëm disa nga obligimet tona, në të cilat jam i përkushtuar t'i realizojmë me sukses të plotë dhe në shërbim të qytetarëve.

Edhe fushat tjera, si sporti, kultura, trashëgimia kulturore dhe rinia, do të përkrahen brenda mundësive tona buxhetore, me projekte konkrete, pasi sukseset dhe përfaqësimi i komunës sonë në vend dhe jo vetëm, janë ndër prioritetet tona, përmes së cilave synojmë të arrijmë më të mirën e mundshme.

Organizmi i festivalit tradicional të folklorit “Oda e Llapushës”, është një nga ngjarjet më të mëdha kulturore, në të cilin marrin pjesë grupet dhe rapsodët më të shquar të trojeve shqiptare, duke e bërë Malishevën një qendër të kulturës dhe ruajtjes së traditës sonë të pasur.

Përmes këtyre, ne synojmë që të bëjmë Malishevën një komunë sa më të zhvilluar dhe të rrisim mirëqenien e qytetarëve, duke bërë veprime dhe hapa konkret, për të realizuar objektivat tona:

1. Menaxhim të mirë të buxhetit
2. Realizimi i projekteve zhvillimore
3. Mbështetje për bizneset, OJQ-të dhe grupet tjera të interesit
4. Shërbime sa më të mira shëndetësore dhe sociale
5. Mbështetje për sektorin e bujqësisë
6. Organizmin e mësimi gjithë ditor (ose në një ndërrim) në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të ulët në fshatra, përjashtuar qytetin e Malishevës.
7. Zhvillimin e infrastrukturës
8. Ofrimin e shërbimeve sa më të mira komunale (furnizimi me ujë dhe menaxhimi i mbeturinave)
9. Zhvillimi i aktiviteteve në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit
10. Zhvillimin e turizmit
11. dhe të tjera, varësisht nga nevojat që paraqiten gjatë rrugës

Ndër pikat më me rëndësi është rritja e transparencës në raport me qytetarin, me theks të veçantë në transparencë të plotë në shpenzimin e buxhetit të komunës. Të gjitha aktivitetet, të hyrat dhe shpenzimet e buxhetit, përfshi edhe realizimin e projekteve kapitale, për çdo cent të shpenzuar, qytetari do të njoftohet përmes bërjes publike të të gjitha raporteve në ueb faqen zyrtare të komunës: malisheve.rks-gov.net dhe në të gjitha hapësirat tjera të mundshme.

Do të vazhdojmë të jemi komuna më transparente dhe me realizimin të plotë të buxhetit sa i përket investimeve kapitale, për çka ne si komunë, unë si kryetra dhe në tërësi si qeveri komunale, tashmë jemi të dëshmuar.

Për realizimin e të këtyre objektivave, të gjitha drejtoritë dhe sektorët brenda institucionit të komunës, i kanë të hartuara planet dhe kanë objektivat që do ti realizojnë.

Kabineti dhe njësitë vartëse të kryetarit:

1. *Rritje e transparencës dhe gjithë përfshirje* - përmes sigurimit të plotë të qasjes në të gjitha aktet e komunës, qeverisje të hapur për qytetarë dhe përfshirja e tyre në vendimmarrje.
2. *Menaxhimi i burimeve njerëzore* – informim të plotë për konkurset në të gjitha sektorët dhe menaxhim i performacës së stafit administrativ të komunës.
3. *Zbatim i plotë i ligjeve, rregulloreve, udhëzimeve administrative*
4. *Bashkëpunim ndërinstitutional dhe bashkëpunime me komunat nga vende të ndryshme*
5. *Promovim i gjithë përfshirjes dhe i barazisë gjinore dhe sociale*
6. *Auditim i plotë i të gjitha proceseve në komunë*
8. *Siguria e përgjithshme dhe siguria në bashkësi*
7. *Shërbime për qytetarët*

Administrata: Ofrimi i shërbimeve për qytetarët, përfshi shërbimin e ofiqarisë, pritja e palëve dhe dhënia e udhëzimeve të nevojshme. Thjeshtëzimi i procedurave dhe shërbime sa më të shpejta për qytetarët. Mirëmbajtja e sistemit të teknologjisë informative. Shërbimet e transportit për nevojat e institucionit të komunës dhe institucioneve tjera, varësisht nga nevojat që paraqiten.

Drejtoria e Urbanizmit: Zhvillimi i procedurave dhe realizim i plotë i projekteve kapitale, të miratuara në Kuvendin e Komunës, brenda buxhetit të komunës për vitin 2025. Realizimi i matjeve dhe hartimi i projekteve sipas planifikimit për këtë vit, si dhe monitorimi i realizimit të projekteve infrastrukturore.

Shërbimet Publike: Rritja e kapaciteteve për furnizim me ujë për pije dhe menaxhimi i rrjeteve aktuale të furnizimit. Menaxhimi i mbeturinave, rritja e cilësisë për një ambient sa më të pastër. Menaxhimi i hapësirave të gjelbëruara, ekzistuese dhe krijimi i hapësirave të reja. Mirëmbajtja e trotuareve ekzistuese dhe ndërtimi i trotuareve të reja. Menaxhimi i rrjeteve të kanalizimit dhe mirëmbajtja e tyre. Organizmi i shërbimit të transportit publik. Ofrimi i shërbimit të varrimit.

Gjeodezi, Kadastër Ofrimi i shërbimeve të plota, të shpejt dhe thjeshtëzim i procedurave, për nevojat e qytetarëve dhe institucioneve.

Drejtoria për Pronë: Ka vazhduar lirimi i hapsirës publike në qytetin e Malishevës. Jep në shfrytëzim pronën Komunale. Bartja e palujtshmërive private në shoqëri në bazë të faljes së qytetarëve. Pregatitja e lëndëve për shpenzim. Përgaditja e lëndëve për ekzekutim dhe lirim të pronës publike. Regjistrimi i pronave dhe ofrimi i shërbimeve për qytetarët.

Mbrojtje dhe Shpëtim: Menaxhimi i situatave, varësisht prej nevojave që paraqiten në terren, përfshi menaxhimin e situatës me Ethet Hemorragjike, menaxhimin e zjarreve, aksidenteve dhe menaxhimin e situatave të mundshme emergjente, siç janë vërshimet apo situatat tjera. Mbajtja e takimeve të rregullta për Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB).

Buxheti dhe Financat: Menaxhimi i buxheti, të hyrave dhe shpenzimeve. Grumbullimi i tatimit në pronë dhe njoftimi i qytetarëve dhe bizneseve për obligimet që kanë, bazuar në rregulloren për Taksa, ngarkesa dhe gjoba. Kryerja e pagesave për shpenzimet kapitale dhe pagesat tjera të planifikuara me buxhetin komunal për vitin 2025. Hartimi i buxhetit për vitin vijues. Organizimi i takimeve publike për projekt buxhet. Organizimi i takimeve për buxhetimin me pjesëmarrje. Raportimi i rregullt, tremujor dhe vjetor, për të hyrat dhe shpenzimet.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm: Krijimi i parakushteve për zhvillim ekonomik lokal. Hartimin e planit për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të Komunës. Implementimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2025-2030. Implementon politikat zhvillimore për turizëm. Bashkëpunon me agjencionet qeveritare për zhvillim për turizëm. Rregullimin dhe mbrojtjen e brigjeve të lumenjve. Bashkëpunim dhe koordinim me Ministrinë për Tregti dhe Industri/ Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik.

Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale: Ofrimi i shërbimeve shëndetësore dhe rritja e cilësisë në këto shërbime. Shërbimet shëndetësore shtëpiake. Meremetimi apo ndërtimi i objektit të ri të QMF- së në Kijevë. Përmirësimi i kushteve në objektet shëndetësore. Shërbimet emergjente. Ofrimi i shërbimeve sociale dhe rritja e mirëqenies sociale.

Kultura, Rinia dhe Sporti: Përkrahja e aktiviteteve rinore dhe sportive, përmes subvencionimit dhe formave tjera, për klubet sportive, organizatat rinore dhe kulturore. Organizimi i festivalit folklorik “Oda e Llapushës”, tashmë festival tradicional. Turne të

ndryshëm me karakter edukativ dhe sportiv. Organizmi i 16 Qershorit-Ditës së Dëshmorëve dhe Ditës së Çlirimit të Malishevës. Organizimi për datat e shënuara, si 17 Shkurti, “Epopeja e UÇK-së”, 18 Nëntori, Flaka e Janarit. Organizimi i aktiviteteve kulture dhe argëtuese gjatë verës, përkatësisht muajve të pushimeve për mërgimtarët. Ruajtja dhe gjetjet arkeologjike, pjesë e pasur e trashëgimisë kulturore dhe historike.

Arsimi dhe Edukimi: Rritja e cilësisë në arsim, investime në objektet shkollore, përmirësimi i kushteve për mësimdhënie dhe mësimnënxje. Organizmi i garave dhe aktiviteteve tjera me karakter edukativ, garues dhe argëtues, bazuar në planifikimet dhe kurrikulat. Rritja e cilësisë në shkollimin e mesëm dhe hapja e drejtimeve të reja, varësisht prej nevojave të tregut të punës në shkollat profesionale dhe ngritja e cilësisë në gjimnazin e përgjithshëm. Realizimin e të gjitha objektivave në arsim, si dhe rritja e kapaciteteve dhe hapja e çerdhe të reja, me qëllim të krijimit të mundësive më të mira për nënat dhe socializimin e fëmijëve.

Inspektorati: Zhvillimi i vazhdueshëm i inspektimeve në terren, për të mos lejuar dëmtimin e pronës publike, ndërtimet pa leje, si dhe inspektim i subjekteve afariste (markete, dyqane, restorante, dhe të tjera), për cilësinë e ushqimit, mallrat me afat të skaduar, pastërtia dhe hapësira e mjaftueshme të zhvillimit të aktivitete të lokaleve apo subjekteve afariste. Inspektimi i ruajtjes së hapësirës publike dhe hapësirës së gjelbëruar, mbrojtja e shëndetit të qytetarëve dhe të tjera.

Bujqësia: Bujqësia, blegtoria dhe zhvillimi rural, është njëri nga prioritetet tona më me rëndësi, sepse është baza e zhvillimit ekonomik në komunën tonë. Për këtë qëllim në vazhdimësi kemi përkrahur dhe do të vazhdojmë të përkrahim fermerët tanë, përmes subvencionimeve, të qumështit dhe formave tjera të përkrahjes. Po ashtu, punimi i tokës është synimi ynë kryesor dhe furnizimi i tregut me produkte vendore dhe të shëndetshme. Përmes formave të pagesave direkte, bashkëfinancimit dhe gjetjes së donatorëve, përkatësisht organizatave të ndryshme, bujqit dhe fermerët do të përkrahen për rritjen e kapaciteteve të tyre dhe rritjen e cilësisë dhe sasisë së prodhimit dhe furnizimin me produkte të shëndetshme vendore.

Fjala përmbyllëse:

Ky plan pune nuk është vetëm dokument i zotimeve, por udhërrëfyesi ynë për vitin 2025. Me përkushtim, transparencë dhe bashkëpunim, do të vazhdojmë të ndërtojmë një Malishevë të zhvilluar dhe moderne, në shërbim të secilit qytetar.